



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.1, datë 09.01.2024

PËR

“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Petrit Çano, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
2. Zoti Petrit Çano do të ushtrojë detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, përkohësisht nga data 10.01.2024 – 09.07.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Petrit Çano, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
4. Gjatë periudhës së transferimit zoti Petrit Çano do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, sipas përcaktimeve të vendimit Nr.386, datë 30.11.2023, për miratimin e Rregullores për “Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 09.01.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla


ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj



  
ANËTAR  
Sokol Stojani

  
ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Mirela Bogdani  


ANËTAR  
Arta Mandro  


ANËTAR  
Ledina Riza  
(Kunder)  


ANËTAR  
Moisi Duda  


ANËTAR  
Vatë Staka  


ANËTAR  
Olger Eminaj  
